

Funksioni komunikativ i njësive gjuhësore dhe jogjuhësore

Mr. Agim Spahiu

20 shkurt 2002

Përmbledhje

Në këtë shkrim kemi bërë përpjekje për t' i klasifikuar njësitë gjuhësore- sintaksore nga aspekti intencional i tyre, që është edhe pika më themelore e të gjitha *akteve të të folurit*. Me fjalë të tjera, këtu kemi synuar t' i paraqesim konturat më kryesore të një klasifikimi nga aspekti pragmatik.

Gjuha është mjete më i përsosur i komunikimit ndërnjerëzor në cilëndo bashkësi shoqërore. Për të komunikuar në mes vete, njerëzit përdorin mjete e njësi të ndryshme gjuhësore dhe jogjuhësore. Këto njësi përbëjnë një korpus a inventar të cilin e posedon çdo folës i asaj gjuhe për të komunikuar në rrethana e situata të caktuara. Në çështjen e komunikimit ndërthuren disa faktorë, ndër të cilët po veçojmë: raportet ndërmjet folësit dhe bashkëbiseduesit, situatat komunikative, rrethanat sociale dhe ambienti ku jetojnë ata individë dhe i tërë kolektiviteti, në përgjithësi, si dhe intencat e përdorimit të atyre mjeteve gjuhësore në momente dhe vende të caktuara. Elementi i fundit është njëri ndër faktorët më qenësor, për çka esencialisht njeriu i krijon ato (mjetet gjuhësore) për t' i realizuar qëllimet e veta në situata konkrete. Materializimi i tyre bëhet nëpërmjet të folurit, por edhe përmes gjuhës së shkruar. Prandaj, nuk ka njësi gjuhësore (sintagmë, fjali e njësi mbifjaljore) që nuk e përmban edhe qëllimin ose arsyen e sajimit e të përdorimit të tyre. Me fjalë të tjera, këto njësi gjuhësore kanë kryesisht vlerë pragmatike, meqë plotësojnë kërkesa a intenca të caktuara, të sajuara me ligjet dhe me mjetet specifike të natyrshme të secilës gjuhë veç e veç.

Në vazhdim do të përpiqemi të japim një pasqyrë të intencave më kryesore të disa njësive gjuhësore që përdoren në komunikimin e përditshëm nga pjesëtarët të të njëjtit komunitet, nëpërmjet akteve të të folurit ose akteve të gjuhës (gjer. *Die Akte des Sprechen*; frëngj. *actes de langage, actes de parole*); një term i konceptuar nga filozofi dhe gjuhëtari anglez J.L. Austin ¹.

¹Shih më gjerësisht: Lutz Götze, Ernest W. B. Hess-Lüttich, *Grammatik der deutschen Sprache, Sprachsystem und Sprachgebrauch*, München, 1999, f. 539-543; H. Pelz, *Linguistik, Eine Einführung*, bot. 4-të, Hamburg, 1999, f.241-251; Grosses Handbuch, *Deutsch Grammatik*, Köln, 1995, f. 335-337; O. Ducrot, J. Schaeffer, *Nouveau dictionnaire encyclopedique des sciences du langage*, 1995, f. 776-787 etj.

Në rrafshin pragmatik, të gjitha njësitë që përdoren në komunikim, në gjuhësi emërtohen si **shprehje** ose **thënie**.

Të gjitha **shprehjet** ose **thëniet** mund të definoohen si struktura gjuhësore të përbëra prej elementeve të caktuara. Në to pasqyrohen të gjitha veçantitë e veçoritë e një gjuhe të individit, në veçanti, dhe të kolektivitetit, në përgjithësi. Ato mund të jenë të llojllojshme në një gjuhë, pra edhe në gjuhën shqipe. Por ne do të ndalemi vetëm te grupi i shprehjeve kumtuese, struktura e të cilave është shumë e larmishme. Forma më e shpeshtë sintaksore e shprehjeve (thënieve) është fjalia, por kjo nuk do të thotë se secila *shprehje* duhet të jetë *fjali*. Ndërtimet gjuhësore si: **Përse? -Ndoshta.-Po. - Zjarr! -Përpara, shokë!** etj., nuk janë fjali gramatikore në kuptimin e mirëfilltë sintaksor, por janë shprehje (thënie), të sajara në përputhje me rregullat e lejuara të gjuhës sonë. Pra, janë pjesë apo akte të të folurit që realizohen kryesisht në bashkëbisedim (në dialog). Por, derisa fjalitë janë njësi sintaksore kumtuese me një sistem të organizuar gjuhësor, me një numër të caktuar elementesh të dorës së parë a të dytë, me bërthamë kallëzuesore, me intonacionin kuptimor të përmbartimit etj., shprehjet (thëniet) mund të mos i kenë të gjitha këto elemente. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se njësitë e lartshënuara nuk *fshehin* në vete fjali. Prandaj studiuesit e gjuhëve të ndryshme kanë krijuar edhe emërtime të veçanta për to. Kështu, bie fjala, studiuesit francezë kanë krijuar për këtë qëllim termat **la phrase** për të shënuar atë unitet të komunikimit gjuhësor, me intonacion të vet të përmbartimit etj., (me një a më shumë elemente a gjymtyrë përbërëse, si p.sh.: *Partez demain matin. Venez.; Sauve! Bravo! Zut!*), në njërën anë, dhe termin *le proposition*, që përbëhet nga një folje të zgjedhueshme ose, më saktë, nga një predikat që ka një subjekt, një sintagmë me funksion të subjektit a të një plotësi tjetër, (gjithnjë në kuptimin të atyre fjalive gramatikore që në literaturën tonë janë quajtur *fjali kryesore dhe të varura të periudhës*, të cilat nuk shquhen me intonacionin e vet të përmbartimit, -A. S.), në anën tjetër².

Edhe gramatikanët anglezë e bëjnë një diferencim të këtillë, duke i përdorur termat **Sentence dhe Clause**.

Ekziston një numër i madh i akteve të të folurit. Por, ato të gjitha do të mund të reduktohenin përgjithësisht në:

- a. Aktet e të folurit që shprehin njoftime dhe konstatime,
- b. Aktet e të folurit që shprehin kërkesa, dhe
- c. Aktet e të folurit që shprehin pyetje.

Të gjitha këto mund t' i korrespondojnë ndërtimeve sintaksore që në gramatikat tona janë klasifikuar si: **1. fjali dëftore; 2. fjali urdhërore e dëshirore dhe 3. fjali pyetëse.**

Në grupin e parë do të përfshiheshin shumë ndërtime që shprehin: **njoftime**, si p. sh.: *Ai udhëton për Berlin. Nesër ata vijnë nga klinika. Zjarrfikësit nuk u njoftuan me kohë, prandaj e tërë shtëpia e tij për një kohë të shkurtër u bë gërmadhë;* etj.: **përsëritje**

²Shih Grevisse § Goosse, *Nouvelle grammaire française*; Ducolot, 1995, f.71 -75; O. Soutet, *La syntaxe du français*, Paris, 1998, f. 8-11; R. Bergentoft, M. Nord § S. Nord, *Grammaire française communicative*, Heidelberg, 1998, f. 141-148.

dhe nderime të ndryshme, si p.sh.: *Mirëmëngjes! Mirëdita! Puna e mbarë! Natën e mirë! Mirupafshim!* etj.; disa shprehje nga përgjigjet e pyetjeve të folësit, si psh.: *-Po. -Posi! -Natyrisht. - Ndoshta! -Kushedi! - Mirë. Po po, mirë!* etj.; **falënderime dhe kërkim faljesh**, p. sh.: *Të falemnderit.; Më fal! Më vjen shumë keq* etj.; **reagime në falënderime dhe në kërkim faljesh**, p. sh.: *Ju lutem! Në rregull. Me nder qofsh!* etj.; **Urime dhe ngushëllime**, si p. sh.: *Urime! Gëzuar Vitin e Ri! Me dëshirat më të mira! Kryet shëndosh!* etj.; **premtime**: *Nesër unë mund t'ju ndihmoj. Ju garantoj se çdo gjë do të shkojë si duhet* etj.

Në grupin e dytë do të përfshihen ato akte të të folurit që shprehin **kërkesa, urdhra, ndalesa, këshilla, udhëzime, lutje, dëshira, propozime** etj. Me fjalë të tjera, këtu do të hynin ato njësi sintaksore kumtuese që në gramatikat tona janë quajtur fjali dëshirore e urdhërore me elemente shpeshherë thirrmore. Ja disa shprehje që ngërthejnë në vete **urdhra**: *Rrini këtu! Ndal! Zgjohu!* etj.; **ndalesa**: *Ndalohet hyrja këtu! Lëre këtë! Mos pini duhan, ju lutem, këtu!* etj.; **rekomandime**: *Me këtë program kompjuterik është më së miri të punohet;* **lutje**: *Ju lutem, më ndihmoni!*; **vërejtje e kërcënime**: *Po bëre edhe një gabim, unë do të nxjerr jashtë;* **dëshira**: *Të na rrosh sa malet! Nusja e pastë këmbën e mbarë! I mallkuar qoftë!* etj.

Ndërkaq, në grupin e tretë do të përfshihen përgjithësisht pyetjet e drejta e të zhdrejta, si dhe ato retorike. **Shprehje (thënie) pyetëse të drejta** do të mund të konsiderohen ndërtimet e tipit, si: *A erdhi Agroni? Pse u shkaktua kjo rrahje në mes tyre?* ose **ato të zhdrejta**: *Nuk e di se si ka përfunduar kjo punë; Se çka mund të bëj për ty, nuk e di as vetë tash për tash. Nuk u tha se çka ndodhi pastaj. Nuk e di arsyen pse ai nuk erdhi mbrëmë;* etj.

Në katër shembujt e fundit të nënvizuar kemi të bëjmë me nënfjali ftilluese pyetëse të zhdrejta.

Shpeshherë mund të ndodhë që të kemi **shprehje eliptike pyetëse** që i drejtohen folësit në bashkëbisedim p.sh.: *- Përse? Me se? Kur? Ku? Në ç'kohë?* etj.; ose **ato retorike**, si p.sh.: *Po, po edhe gaforrja bën jetë, por çfarë jete bën se...??!* etj. Pra, në këto **grupe shprehjesh**, siç po shihet edhe nga shembujt, përfshihen struktura nga më të ndryshme: nga fjalët e vetme, e deri te njësitë më të ndërlikuara, siç është fjalia, periudha e teksti me një përmbajtje kompakte. Pra, të gjitha ato ndërtime që kanë vlerë kumtuese-komunikative dhe që shprehin diçka nga realiteti subjektiv dhe objektiv.

Si përfundim, nga e gjithë kjo që u tha del se çdo akt i të folurit përmban: 1) mjetet gjuhësore të gjuhës së caktuar (tingujt, fjalët, fjalitë etj.), të përdorura sipas ligjeve të asaj gjuhe; 2) intencën ose qëllimin e folësit për të cilën gjë janë sajuar këto mjete, jo vetëm gjuhësore, të cilat rregullojnë raportet ndërmjet bashkëbiseduesve në komunikim; dhe 3) pritjen e folësit që intenca e tij e shprehur të realizohet duke reaguar aty për aty (madje edhe refuzimi i ndonjë kërkesë nga ana e bashkëbiseduesit është rrjedhojë e saj).

E gjithë kjo në teorinë gjuhësore mund të përmbledhet në:

- aktin lokutiv me aspektet e tij: fonetik, fatik (gjer. fatischer Akt) dhe retik (gjer. retischer Akt);
- aktin illokutiv me të cilin realizohet intenca dërguese (gjer. Senderintencion); dhe

- aktin perlokutiv me çka synohet të arrihet efekti i tij³.

Në anën tjetër, këtu vlen të theksohet se komunikimi ndërmjet njerëzve mund të realizohet edhe me mjete të tjera jashtëgjuhësore. Në radhë të parë, këtu do të merren parasysh **mimika dhe gjestikulationet**, të cilat te disa njerëz janë të zhvilluara mjaft shumë, pastaj të komunikuarit me anë të gishtërinjve (siç është rasti për shurdhë-memecët), **me anë të vizatimeve, shenjave, figurave, simboleve, sinjaleve**, të cilat kanë një përdorim shumë të gjerë, veçanërisht në lëmin e komunikacionit, telekomunikacionit, të informatikës etj.

³Shih H. Pelz, Vep. e cit., f. 245-247.